



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P nr. 4/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, sipas Kryetares se trupit gjykues – Lumturije Muhaxheri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shpresa Kërnya, në lëndën penale të pandehurit A. I, nga , Komuna ..., për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, , PP/I nr.1/16 dt.14.01.2016, në seancën e shqyrtimit fillestar, publik, të mbajtur me dt.19.01.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Agim Kurmehaj, të pandehurit A. I , të njëjtën ditë mur dhe publikisht shpalli dhe me dt. 25.01.2016 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri A.I, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr...., i lindur me dt...., në fsh..., Komuna Pejë, me vendbanim të përhershëm në ..., i biri i ... dhe nënës ..., e gjinisë ..., ka të kryer shkollën ..., me profesion, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i dënuar.

ËSHTË FAJTORË

Për shkak se:

Me dt.31.12.2015, rreth orës 31.12.2015, në fsh...., Komuna Pejë, i njëjti përdor armën në mënyrë frikësuese dhe atë pistoletën e prodhimit Çekoslovak “Vzor, modeli 70, me nr.serik 15398, në atë mënyrë që ditën kritike shkon në shitoren e fshatit, e cila ishte e mbushur me myshteri dhe posa hyn brenda saj, duke mbajtur një revole në dorë ju drejtohet të pranishmëve

me fjalët “kush është trim le të ri, tucat le të dalin përjashta”,

- me çka ka kryer veprë penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshme nga neni 375 par.2 të KPRK-së.

Gjykata me aplikimin e neneve 4, 7, 17 par.1, 21 par.2, 41, 46, 62 par.2 pika 2.7, 69, 73, 75 par.1 pika 1,3 , 375 par.2 të KPRK, nenit 365, 366, 453, e në pajtim me nenet 233, 247, 248 të KPPRK-së, te pandehurit i shqipton,

DËNIM ME KUSHT

Duke ia përcaktuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 (dy) vjetësh nuk do të kryen ndonjë veprë te re penale dhe,

Dënim me gjobe ne shume prej 500 € (pesqindeuro), të cilën shumë është i detyruar ta paguaj në afat prej 90 (nëntëdhjete) ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast të mospagimit të dënimit me gjobë, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ne kohë zgjatje prej 25 (njëzetepesëditësh), ashtu që çdo 20 € (njëzetë euro), të dënimit me gjobë, i përcakton 1 (një), ditë burg.

Ndaj të pandehurit i shqiptohet dënimi plotësues konfiskimi i armës dhe atë një pistoletë e dhe urdhërohet shkatërrimi i saj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, numri i rastit në polici.....

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor Gjykatës, ti paguaj shumën prej 50 € (pesdhjetëeuro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të behet i plotfuqishëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Pejë - Departamenti për Krime të Rënda , ka ngrit aktakuzë PP/I nr.1/16 dt.14.01.2016, kundër të pandehurit A. I, nga fsh..., Komuna Pejë, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 KPRK –së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit te Shtetit PP/I nr.1/16 dt.14.01.2016, në seancën e shqyrtimit fillestar, Gjykata është bindur së i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe duke vepruar në kuptim të nenit 246 par.4 të KPPRK-se , të pandehurit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë. Me këtë rast, Gjykata e ka udhëzuar të pandehurin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPK-se, kështu që i pandehuri ka deklaruar së është plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe shton së ky deklarim paraqet shprehje të vullnetit të tij të lirë, pasi ai është kryes i kësaj veprë penale të cilën nuk ka si ta mohoj, në tërësi e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar sipas aktakuzës dhe se pranimi i tij është i mbështetur edhe në provat të cilat i janë ofruar gjykatës me aktakuzë, të njëjtit i vjen keq për rastin dhe se është penduar duke i premtuar gjykatës që në te ardhmen nuk do ti përsërisë veprimet e tija, njëherit para gjykatës i kërkon falje publike familjes së dëmtuar .

Pas deklarimit të pandehurit për pranimin e fajësisë, Gjykata kërkoi nga Prokurori i shtetit dhe mbrojtësi të japin mendimin e vetë për pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit, në këtë drejtim deklaroi se pajtohet në tërësi me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, me qenë se një pranim i tillë ka mbështetje në provat në bazë të cilave është ngritur aktakuza, i ka propozuar gjykatës që të pranoj një pranim të tillë, propozon që te konfiskohet arma dhe municioni i përshkruar si ne dispozitiv te akuzës.

Mbrojtësi i pandehurit ..., në këtë drejtim deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e klientit te tij , i cili pranim është bërë pas konsultimit paraprak që e kishin pas në mes veti, dhe pasi të njëjtit paraprakisht ia ka shpjeguar të mirat dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ashtu që e mbështet pranimin e fajësisë.

Në vijim, Gjykata duke e shqyrtuar pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurit vlerësoi së pranimi i fajësisë paraqet shprehje të vullnetit të lirë të pandehurit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pranimi i fajit është bërë në mbështetje të fakteve të prezantuara në aktakuzë, në përputhje me kërkesat e nenit 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPR të Kosovës.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga gjendja e vërtetuar faktike, siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit A.I , qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 KPRK –së.

Sa i përket fajësisë, Gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i njëjti ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj .

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke pas parasysh se Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ne shqyrtimin fillestar dhe, ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 248 par 4 të KPPRK-së, në këtë çështje penale nuk është zbatuar seanca e dytë e shqyrtimit gjyqësor e as shqyrtimi gjyqësor, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, njëherit bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Prishtinë dhe, Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të EULEX-it, me nr.GjA.nr.207/13 dt.19.03.2013, me rastin e shpalljes se te pandehurit fajtor dhe shqiptimin e dënimit nuk është plotësuar fare trupi gjykues.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim te nenit 73 par.1 te KPRK-se. Kështu si rrethana rënduese gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti edhe më parë ka qene i gjykuar për vepër penale te vrasjes i cili edhe ka vuajtur dënim dënimin me burg prej 11 vite e gjashtë muaj të cilin fakt e pohon vete

i pandehuri , kurse si rrethana lehtësuese për te pandehurin, Gjykata ka vlerësuar sjelljen e tij korrekte gjate shqyrtimit fillestar, është përnduar për veprën penale, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen një gjë e tillë më nuk do të përsëritet, kërkim faljen publike familjes së dëmtuar ,nivele e ulet te arsimimit, të cilat gjithashtu kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana favorizuese. Si rrethanë veçanërisht lehtësuese gjykata e merr faktin se i pandehuri qysh ne fillim te hetimeve e edhe ne shqyrtimin e seancës fillestare e ka pranuar fajësinë për veprën penale, gjë qe dëshmoi gatishmëri për bashkëpunim me organin e akuzës dhe me gjykatën dhe kjo sipas vlerësimit të gjykatës paraqet pendim të sinqertë të tij dhe fillim të procesit të rehabilitimit të tij, ne prezencën e këtyre rrethanave lehtësuese dhe renduese , komfor nenit 75 par.1 pika 1,3 te KPRK-së te akuzuarin e ka gjykuar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi me te cilën do te arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu te gjitha rrethanat e parashikuar me nenin 73 par.1 te KPRK-se, Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale te tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do te shërbej për arritjen e qëllimit te dënimit ne pengimin e pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen por ai do te ndikoj edhe si preventive gjenerale për personat tjerë qe te përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 41 te KPRK-se .

Vendimin mbi dënimin plotësues marrjen e armës dhe municionit të përshkruar si në dispozitivi te këtij aktgjykimi, u murr komfor nenit 62 lidhur me nenin 69 te KPRK-se

Duke u bazuar ne nenin 450 par 2 pika 2.6 te KPPRK-se, Gjykata ka vendosur qe te pandehurin ta obligoj në pagimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësorë.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar ne nenin 368 par.2 te KPPK-se, Gjykata palët ne procedure i njoftoi me paralajmërimet qe shoqërojnë aktgjykimin.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,
P.nr. 4/2016 të dt. 19.01.2016, përpiluar me dt.25.01.2016**

**Sekretarja Juridike
Shpresa Kërnja d.v.**

**Kryetarja e Trupit Gjykses
Lumturije Muhaxheri d.v.**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa ne afat prej 15 detesh, nga dita e marrjes, Gjykatës se Apelit ne Prishtine, e përmes kësaj Gjykate.